



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 10 nëntor 2014
Nr. ref.:RK723/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI63/14

Parashtrues

Misin Rifati

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në
Ferizaj, C. nr. 71/2002, të 17 dhjetorit 2002**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Misin Rifati (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) me banim në Talinoc i Jerlive, komuna e Ferizajt.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin C. nr. 71/2002 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 17 dhjetorit 2002, që i është dorëzuar atij më 20 janar 2003.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës], nenin 54 [Mbrotjtja gjyqësore e të drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 prill 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI63/14 caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI63/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 23 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 17 gusht 2001, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale nxori Aktvendimin T. nr. 8/2001 për ndarjen e trashëgimisë së babait të tij të ndjerë, të cilin aktvendim parashtruesi i kërkesës nuk e kishte dorëzuar në Gjykatë.
9. Më 17 dhjetor 2002, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 71/2002) (në rastin civil të S. R. kundër të tjerëve duke përfshirë parashtruesin e kërkesës), vërtetoi se S. R. është pronar i pronës së paluajtshme nr. 318 në "Dugaqke Njive- Arat e Gjata". Sipas dokumenteve të dorëzuara asnjë ankesë nuk është parashtruar brenda afatit të caktuar.
10. Gjatë vitit 2006, parashtruesi i kërkesës iu drejtua disa institucioneve lidhur me pakënaqësinë e tij me rezultatin e rastit të lartpërmendur.

11. Më 12 mars 2013, parashtruesi ka parashtruar një kërkesë për "*rishikimin e propozimit per ndarjen fizike*" në Gjykatën Komunale në Ferizaj. Rasti është ende në procedurë e sipër në Gjykatën Komunale (rasti C. nr. 180/2013).

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].
13. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata "*të konfirmojë se prona e paluajtshme nr. 318 në "Dugaqke Njive- Arat e Gjata" duhet të trasnsformohet nën emrin tim*".

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë.
15. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h), i cili parasheh: "*Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme kur kërkesa nuk është racione temporis në pajtim me Kushtetutën*".
16. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast të veçantë, koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesi ankohet dhe përmasën e të drejtës së Kushtetutës që pretendohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Rastin *Blečić kundër Kroacisë*, Kërkesa Nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82).
17. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin C. nr. 71/2002 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 17 dhjetorit 2002, i cili i ishte dorëzuar atij më 20 janar 2013.
18. Kjo do të thotë që shkelja e pretenduar e të drejtës së parashtruesit, e garantuar me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës, dhe prej të cilës datë Gjykata ka juridiksion kohor.
19. Prandaj, rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.
20. Megjithatë, Gjykata vëren se më 2013, parashtruesi i kërkesës tanimë ka bërë një parashtrësë në Gjykatën Themelore, duke kërkuar nga gjykata që të shqyrtojë vendimin e kontestuar. Ky rast është ende në pritje në këtë gjykatë (rasti C. nr. 180/2013).
21. Gjykata rikujton se në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi ka për detyrë që të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.

22. Në rastin konkret, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, pasi që nuk ka vendim përfundimtar për t'u kontestuar.
23. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me rregullat 36 (3) h) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani